REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 310, Datë 26.10.2026

MBI

MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "SPV BLUE 2" SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW DHE NJOHJEN E LEJIMIN E VIJIMIT TË OPERIMIT TË IMPIANTIT TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE SIPAS REGJIMIT KALIMTAR TË PARASHIKUAR NË LIGJIN NR. 59/2026

Në mbështetje të neneve 16, 51 dhe 136, pika 2 të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; nenit 13, 15 dhe 14, pika 9, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma "a" të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE*-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2037/18 prot., datë 26.10.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "SPV Blue 2" sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW*",

Konstatoi se:

- Shoqëria "SPV Blue 2" sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 296, datë 30.12.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2037/1 prot., datë 09.07.2026, dhe nr. 2038/1 prot., datë 13.07.2026, shoqëria ka kërkuar modifikimin e Aneksit A të licencës, për pasqyrimin e rritjes së kapacitetit të instaluar të centralit nga 50 MW në 100 MW dhe përfshirjen e sistemit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS), me kapacitet 200 MW, si vepër ndihmëse, me qëllim absorbimin e tepricave të prodhimit nga parqet fotovoltaike të projekteve BLUE dhe reduktimin e disbalancave të gjenerimit.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 203, datë 21.07.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike. Për sa kërkuar nga shoqëria për të përfshirë në licencën e prodhimit dhe veprat ndihmëse, në këtë vendim është përcaktuar se do t'i kërkoht shoqërisë qëndrimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) e po ashtu, se vetë ERE do të njoftojë MIE-n në kuadër të kësaj procedure.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 23.07.2026 dhe 24.07.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.08.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresat nr. 2037/4 prot. dhe nr. 2037/5 prot., datë 30.07.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë "SPV Blue 2" sh.p.k. për fillimin e procedurës së modifikimit të licencës, duke

kërkuar plotësimin e dokumentacionit dhe depozitimin e qëndrimit të MIE-s, si dhe ka njoftuar AKM-në dhe OSSH sh.a. për fillimin e procedurës. Gjithashtu, me shkresën nr. 2234 prot., datë 27.07.2026, ERE ka njoftuar MIE-n për këtë procedurë.

- Në vijim, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën nr. 2037/6 prot., datë 07.08.2026.
- Pas shqyrtimit të aplikimit dhe dokumentacionit të administruar, u vlerësua e nevojshme marrja e qëndrimit të AKM-së lidhur me vlefshmërinë dhe vijimin e efekteve juridike të vendimit për VNM Paraprake nr. 76, datë 11.07.2023, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 2037/11 prot., datë 03.09.2026, ndërsa shoqëria, me komunikimet e protokolluara me nr. 2037/12 prot., datë 14.09.2026, nr. 2037/13 prot., datë 17.09.2026 dhe nr. 2037/14 prot., datë 22.09.2026, kërkoi shtyrje të afatit për depozitimin e dokumentacionit dhe informoi ERE-n se kishte kërkuar rikonfirmimin e VNM-së Paraprake nga AKM-ja.
- Në kuadër të komunikimeve të zhvilluara gjatë procedurës administrative, shoqëria "SPV Blue 2" sh.p.k., me komunikimet e protokolluara në ERE me nr. 2037/12 prot., datë 14.09.2026, dhe nr. 2037/13 prot., datë 17.09.2026, ka saktësuar se kapaciteti i impiantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS) është 300 MW/802,5 MWh, në ndryshim nga kapaciteti prej 200 MW i deklaruar në kërkesën fillestare.
- Në këto kushte, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 276, datë 25.09.2026, u vendos pezullimi i procedurës administrative për modifikimin e licencës së shoqërisë "SPV Blue 2" sh.p.k., lidhur me rritjen e kapacitetit të instaluar nga 50 MW në 100 MW, deri në depozitimin e qëndrimit të AKM-së mbi vlefshmërinë e vendimit për VNM Paraprake nr. 76, datë 11.07.2023, ose mbi nevojën për pajisjen me akte të tjera mjedisore sipas legjislacionit në fuqi. Me shkresën nr. 2037/16 prot., datë 06.10.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim, duke vënë në dijeni edhe AKM-në.
- Në vijim, me shkresën nr. 2037/17 prot., datë 16.10.2026, shoqëria "SPV Blue 2" sh.p.k. ka depozituar pranë ERE-s vendimin për VNM Paraprake nr. AN011020260360, datë 15.10.2026, për zhvillimin e projektit "Parku fotovoltaik 'Blue 2' sh.p.k., me kapacitet 100 MW + sistemi i ruajtjes së energjisë me akumulatorë me kapacitet 100 MW". Me depozitimin e këtij vendimi, vlerësohet se është përmbushur kërkesa për dokumentacionin mjedisor, për mungesë të të cilit ishte pezulluar procedura administrative me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 276, datë 25.09.2026. Për rrjedhojë, konsiderohet i ezauruar shkaku i pezullimit dhe janë krijuar kushtet për vijimin e shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Në lidhje me kërkesën e shoqërisë për përfshirjen e sistemit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS) si vepër ndihmëse, ERE, me shkresën nr. 2234 prot., datë 27.07.2026, ka njoftuar MIE-n për këtë kërkesë dhe në vijim, me shkresën nr. 2037/7 prot., datë 21.08.2026, i ka kërkuar qëndrimin e saj, përfshirë sqarimin nëse për përfshirjen e këtyre veprave kërkohet miratim paraprak, ndryshim i Miratimit për Ndërtim apo procedurë tjetër administrative. Me shkresën nr. 6448/2 prot., datë 27.08.2026, protokolluar në ERE me nr. 2234/2 prot., datë 28.08.2026, MIE ka sqaruar se, në zbatim të nenit 51, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 59/2026, shoqëria mund të vijojë operimin e impiantit të depozitimit sipas licencës ekzistuese, gjatë periudhës kalimtare dhe në përputhje me kushtet e afatet e përcaktuara në këtë dispozitë.
- Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë saktësimin e kapacitetit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS) në 300 MW/802,5 MWh, vlerësohet që shoqërisë "SPV Blue 2" sh.p.k., t'i lihet detyrë të sigurojë që gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, fuqia totale e injektuar në pikën e lidhjes me rrjetin të mos tejkalojë në asnjë moment 100 MW, përkatësisht kapacitetin e instaluar të

centralit fotovoltaik të licencuar, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.

- E drejta e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, i njihet shoqërisë, sipas licencës ekzistuese, deri në përfundim të periudhës 12-mujore të përcaktuar në nenin 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026, brenda së cilës shoqëria duhet të aplikojë për licencë për operimin e impiantit të depozitimit sipas legjislacionit ne fuqi.
- Po ashtu, duke qenë se me vendimin nr. 230, datë 18.08.2026, ERE ka miratuar "Rregullat për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar", vlerësohet se informacioni dhe dokumentacioni i administruar në këtë procedurë mund të përdoret edhe për qëllimet e njoftimit dhe regjistrimit, duke u plotësuar, kur është e nevojshme, me dokumentacionin shtesë të kërkuar.
- Rezulton se shoqëria ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në "*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike"*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe ka shlyer të gjitha detyrimet në lidhje me pagesat e rregullimit. Po ashtu, rezulton se shoqëria ka kryer dy herë pagesën e aplikimit për modiofikimin e licencës, ndaj në lidhje me pagesën e kryer tepër, kjo vlerësohet që të rakordohet në vijim me strukturën e Financës, duke u marrë në konsideratë në raport me detyrimet financiare të pagesave të rregullimit që shoqëria do të ketë ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë Aneksin A të licencës së shoqërisë "SPV Blue 2" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 296, datë 30.12.2024 për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, duke ndryshuar kapacitetin e instaluar të centralit nga 50 MW në 100 MW.

2. Shoqëria "SPV Blue 2" sh.p.k. të fillojë ushtrimin e veprimtarisë për kapacitetin 100 MW brenda datës 31.03.2027.

3. Të njohë operimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike të deklaruar nga shoqëria me kapacitet total energjitik 300 MW/802,5 MWh, dhe të lejojë vijimin e operimit të tij në kuadër të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 296, datë 30.12.2024 dhe ndryshuar me këtë vendim, vetëm për periudhën kalimtare të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*".

4. Shoqëria "SPV Blue 2" sh.p.k. ka detyrimin të sigurojë që, gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë, fuqia totale e injektuar në pikën e lidhjes në rrjet të mos tejkalojë në asnjë moment 100 MW, përkatësisht kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaik të licencuar, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.

5. Për vijimin e operimit mbas afatit të përcaktuar në piken 3 të këtij vendimi shoqëria ka detyrimin që, brenda afatit 12-mujor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 51 të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike", të paraqesë pranë ERE-s aplikimin për licencimin e

veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi për ushtrimin e këtij aktiviteti.

6. Njohja dhe lejimi i operimit sipas këtij vendimi nuk përbën dhënie apo modifikim të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe nuk ndryshon kapacitetin e instaluar sipas përcaktimeve të pikë 1 të këtij vendimi.

7. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosur në pikën 2 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të një dokumentacioni të ndryshëm nga ai që ka shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

8. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "SPV Blue 2" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a.për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI